



5/4/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



III- Nr. l prot. 1422 Më Dt. 05-04-2023
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Raport i Punës –TM1/2023

Erhan Morina

KOMUNA RAHOVEC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

DATË /A:	5.04.2022
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-mars 2023



DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2023. Në kuadër të DEZHT, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar shumë aktivitete.

1 Aktivitetet e Drejtorisë;

Në muajin janar, janë bërë të gjitha barazimet financiare në qira dhe në taksa afariste për vitin 2022, si dhe është bërë inkasimi i borxheve të trashëguara nga viti paraprak.

Është mbajtur sesion informues për aplikim në fondet e IPA-s, në projektet ndërkufitare, ku komuna e Rahovecit do të aplikoj në këto fonde në sektorin e turizmit.

Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Komuna e Rahovecit, mban raporte të mira me këtë ministri. Jemi në pritje të konfirmimit për projektin “Ndërtimi i Ballkonit Panoramik” .

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Gjatë periudhës janar-mars, janë mbajtur takime të rregullta me Komisionin Qeveritar për vlerësimin e dëmeve në ekonomi familjare, amvisëri dhe biznese. Raporti i dëmeve të komunës së Rahovecit, është kualifikuar nga ky komision dhe aktualisht jemi në pritje të marrjes së një vendimi nga qeveria për kompensimin e dëmeve.

Gjatë periudhës raportuese janar-mars, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm ka propozuar dhe ka inicuar në kuvend disa pika të rendit të ditës:

1. Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022;
2. Dhënia në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, të 4 parcelave te depot e Matreksit në Xërxë, ku deri më tani është mbyllur ankandi dhe jemi në procedurë të hapjes së ofertave;
3. Dhënia në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, të 7 lokaleve te palestra "Mizahir Isma" ku ka përfunduar ankandi dhe ka veç 2 ofertues, jemi në procedurë të hapjes së ofertave;
4. Dhënia në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, të tregut ditor në fshatin Ratkoc. Jemi në pritje të ligjshmërisë nga MAPL;
5. Plotësim ndryshimi i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20;
6. Falja e borxheve për bizneset pasive nga viti 01.01.2000 deri me 31.12.2017. Kjo pikë është miratuar në kuvend dhe jemi në pritje të ligjshmërisë nga MAPL;
7. Shfuqizimi i Vendimit të fabrikës së kartonit, e cila është miratuar në kuvend dhe jemi në pritje të ligjshmërisë.

1.1 Investimet Kapitale

Në periudhën janar –mars të vitit 2023, janë zhvilluar punime në këto projekte:

1. Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec, ku gjatë periudhës janar-mars, kanë përfunduar rreth 90% të punëve në ndërtimin e vrazhdë. Pritet që sipas planit dinamik, gjatë muajve në vazhdim, të punohet në suvatimin , punët me kanalizimin, ujë dhe rrymë elektrike etj.
2. Poashtu, në projektin Rregullimi i Oborrit te Depot e Matreksit" në Xërxë, kanë vazhduar punimet në rregullimin e oborrit, ku janë vendosur rrethojat, është vendosur ndriçimi publik sipas paramasës dhe po ashtu ka pasur mbushje dhe rrafshim të dheut. Në këtë projekt janë realizuar rreth 80% të punimeve dhe pritet që projekti të përfundojë në muajin prill.

KOMUNA RAHOVEC

3. Në muajin mars, është lidhur kontrata për projektin; “Ndërtimi i Parkut Industrial në Opterushë” projekt ky i cili do të financohet nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe komunës së Rahovecit. Ky projekt kap vlerën 1688,216.52€ dhe pritet të përfundojë më 08.07.2024
4. Poashtu, jemi duke përgatitur paramasën për projektin: “Investime në Turizëm”, projekt i cili do të realizohet gjatë vitit 2023.

1.2 Sektori për Ekonomi

Gjatë periudhës janar-mars në sektorin për ekonomi janë regjistruar të gjitha subjektet afariste prej librit kryesor të vitit 2022, në regjistrin e librit të vitit 2023.

Në fillim të vitit 2023, është bërë kalkulimi i ngarkesave në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave në taksë afariste komunale për vitin 2023 si dhe është bërë planifikimi i të hyrave për vitin 2023.

Në tabelën më poshtë po paraqesim të hyrat në taksa afariste për periudhën janar-mars 2023.

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksa afariste në periudhën janar-mars 2023	13,576.00 €

1.3 Sektori për Zhvillim.

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht i menaxhon tridhjetë e gjashtë (36) kontrata.

Poashtu, në periudhën janar-mars 2023, pëlqime të punës janë lëshuar gjithsej (50) pesë dhjetë.

Të hyrat në qira për periudhën janar-mars janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë në TM1	21,327.27 €

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

1.4 Zyra e QKRB-së:

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-mars 2023:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	49
2	Informata të ndryshme	38
3	Vërtetim individual	14
4	Shuarje e njësisë	0
5	Shuarje të biznesit	15
6	NUI	16
7	Njësi e re	3
8	Ndryshim nga B.I në SH.P.K	2
9	Informata të ndryshme për biznese, ndërrim të emrit tregtar	1
	Ndërrim pronari, ndërrim i aktivitetit, ndërrim i adresave	33
10	Certifikat e dëmtuar	6
11	Informata të ndryshme për palë	46
	Gjithsejtë lëndë të kryera	223

1.5.Menaxhimi i Asteteve komunale

Sektori për asete komunale ka regjistruar me kohë të gjitha transaksionet e vitit 2022, ndërsa për vitin 2023, për periudhën janar-mars, nuk ka pasur regjistrime për arsye të lëshimit me vonesë të sistemit SIMFK.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Gjatë periudhës janar-mars zyra për menaxhimin e aseteve komunale, ka mbajtur pike informuese në K.K Rahovec, mbi menaxhimin e aseteve jo financiare për vitin 2022.

Në muajin mars, është hapur ankandi për shitjen e aseteve të papërdorëshme të komunës. Ankandi ka qenë i ndarë në 4 llote. Aktualisht janë lidhur kontratat për 3 llote, ku pritet të ekzekutohen pagesat dhe të merren asetet e kontraktuara.

1.6.Sektori i Turizmit

Zyra për Informacione Turistike, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-mars, 2023 si në vijim:
Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me organizatën UNDP në lidhje me projektin për Programin Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2-ReLoad2; Përcaktimi i prioriteteve për thirrjen e dytë të granteve për OJQ-të.

Gjatë periudhës janar-mars janë mbledhur të gjitha informacionet e pikave turistike të trashëgimisë, natyrore, kulturore dhe fetare në bashkëpunim me organizatën OKR dhe Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.

Sigurimi i informacioneve turistike për sektorin e verarisë dhe vreshtarisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë.

Mbajtja e takimit me kompaninë Congress and Event Organization (CEO) nga Prishtina për të marrë pjesë në panairin e turizmit në Prishtinë, në Prill 2023 në këtë panair janë të ftuara të gjitha bizneset e komunës së Rahovecit, të cilat do të kenë mundësi që t'i promovojnë e produktet të tyre.

Me respekt

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm